



---

REPUBLIK QIPËRISË  
BASINIA VLORE  
DREJTORIA JURIDIKE  
NJËSIA E PROKURIMIT

**PROCES VERBAL**

**Tipi i kontratës – e hapur mbi kufirin e larte monetar/Sherbime**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE  
DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është përfekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**Objekti:** Studim i Fizibilitetit për Projektin ‘‘Përmirësimi dhe Zhvillimi i Sistemit të Menaxhimit të Ujërave të Shiut në Qytetin e Vlorës’’

**Fondi Limit:** 25,000,000 (njetete e pesemilion) leke pa tvsh

**Fondi limit:** 262,247 (dyqind e gjashtedhjetë e dymije e dyqind e dyzete e shtate) euro

(me kurs kembimi 95.33 sipas Bankes se Shqiperise, publikuar date 02.06.2026)

**Kodi CPV:** 79314000-8 - Studimi i fizibilitetit

Në bazë të nenit 21 pika 2 të Ligjit nr.162/2020 ‘‘Për prokurimin publik’’, si dhe VKM nr.285, datë 19.05.2021 ‘‘Për miratimin e rregullave të prokurimit publik’’, autoriteti kontraktor ka hartuar kriteret e mëposhtme të kualifikimit dhe specifikimet teknike për realizimin e procedurës së prokurimit me objekt shërbimi mbikqyrje.

## **I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10;*

---

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenet 76 dhe 82 të LPP Nr. 162 datë 23.12.2020, si dhe nenin 26 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", me ndryshime, ku mes të tjerave citohet se: *"Autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të LPP. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik"*.

*b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3.*

**Argumentimi:** Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 "Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit" dhe Neni 83 "Sigurimi i ofertës", të Ligjit Nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik" si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik: citojme Neni 83 i LPP *"Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël"*, Neni 82, i LPP "1. Bashke me dorezimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prove paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose pale të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik".

## **2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar**

### **Ofertuesi duhet të paraqesë:**

#### **1.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

- a) Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2023, 2024, 2025 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% të vlerës së parashikuar të kontratës objekt prokurimi.

### **Argumentimi:**

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

*Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Lloji i procedure është "E Hapur", përcaktimi i vlerës së kërkuar është bërë në mbështetje të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar ku përcaktohet se: "40% të vlerës së parashikuar të kontratës në procedurat e prokurimit..... si dhe në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", si dhe në Udhëzimin e Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar.*

---

*Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ne mbeshtetje te nenin 43, pika 1 ” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ku percaktohet se: ” Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare”.*

- b)** Operatori ekonomik duhet të paraqesi kopje të çertifikuara të bilanceve të 3 (tre) viteve të fundit ushtrimore (2023, 2024, 2025) të paraqitura në autoritet përkatëse Dega e Tatim Taksave, të konfirmuara nga ky autoritet, ku te pakten ne dy bilancet te njepasnjeshme, nuk ka raport negative ndermjet aktivitet dhe pasivitet.
-

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

*Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: “Çdo tatimpagues përgatit deklaraten vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaraten vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.*

*Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenit 41 shkronja c” të Ligjit nr. 1009/2009: “Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikim të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë **dy prej tre treguesve të mëposhtëm:** i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël".*

- c) Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2023, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, (i ndryshuar).

*Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga autoriteti përkatës në të cilin është regjistruar sipas QKB.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar në nenin 77, pika 3, e LPP, nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe ligjin nr.9920 date 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2, gërma d) dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar.

Ky kriter shërben për të garantuar AK se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedure prokurimi, kanë kapacitetet e duhura ekonomike dhe financiare si dhe janë të përshtatshëm për të kryer veprimtari profesionale. Referuar sa më sipër, Autoriteti Kontraktor gjykon se kriteri i vendosur lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të deklaratës për shlyerjen e detyrimeve vendore për vitin 2023, pranë bashkisë/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari Biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t’iu nënshtuar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

## **2.3 Kapaciteti teknik:**

### **2.3.1 Pervoje e suksesshme në realizimin e të paktën:**

Operatori Ekonomik duhet të paraqesë shërbime të ngjashme me objektin e prokurimit ne nje vlere **jo me te vogel se 40%** e te vleres se perlllogaritur te kontrates qe prokurohet dhe qe eshte realizuar gjate tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës

*Për të vërtetuar këtë Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:*

- a) Vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.ose
- b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si deshmi pranohen vetem fatura tatimore të shitjes **të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara ne organet tatimore**, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë ne vlerën jo më pak se 30 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

---

Në zbatim të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, nenit 55, pika 4, germa b) në vlerën 30% të fondit limit.

---

**Shënim:** Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.

### 2.3.2 Liçensa profesionale lidhur me shërbimet objekt i kontratës:

**Liçensa profesionale të shoqërisë (e vlefshme) për projektim (leshuar nga Institucioni i Autorizuar sipas legjislacionit në fuqi për dhënien e licensave profesionale në fushën e studimit e projektimit në ndërtim), ku të përfshihen kategorite:**

- 8.a – Rilevime Inxhinierike
- 5.c - Projektim ujësjellës kanalizime urbane - rurale
- 8.c – Sisteme GIS
- 9.e - Studime e projektme hidrogeologjike.

*Sqarim: Për licencat e lëshuara pas hyrjes në fuqi të Vendimit nr.943, datë 28.12.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.759, datë 12.11.2014, të Këshillit të Ministrave ‘Për licencimin profesional të individëve dhe personave juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”i ndryshuar me VKM. Nr. 943 date 28.12.2016. Ofertuesit duhet te sjellin Liçencat e rinovuara ne zbatim te ketij vendimi.*

*(Për Operatorët e huaj të bëhet njehsimi i liçencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë institucionit përkatës, në plotësim të licensave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës).*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, germa a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe vendimin nr.759, datë 12.11.2014 të Këshillit të Ministrave, “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e koaludimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, ndryshuar me VKM-në nr.943 datë 28.12.2016” (shënim-përcaktoni aktin ligjor ose nënligjor specifik dhe nenin përkatës, që parashikon licencimin e subjekteve, në lidhje me veprimtarinë përkatëse për realizimin e shërbimeve objekt kontrate).

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i

kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente. Licensat e mësipërme janë vendosur në kuadër të natyrës së përgjithshme të punimeve që priten të realizohen në këtë procedurë.

Vlerësojmë që operatorët ekonomikë duhet të zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm dhe të pranueshëm cilësie.

Më konkretisht, po paraqesim argumentimet si më poshtë:

<i>KATEGORIA E KËRKUAR</i>	<i>PËRSHKRIMI I KATEGORISË</i>	<i>ARGUMENTIMI</i>
<b>8- a</b>	Rilevime inxhinierike	Kërkohe sepse studimi mbështetet në të dhëna të sakta topografike dhe gjeodezike të territorit. Kjo kategori mbulon matjet e terrenit, përcaktimin e koordinatave, kuotave dhe karakteristikave fizike të zonës, të cilat përbëjnë bazën e çdo analize hidraulike dhe hidrologjike.
<b>5 – c</b>	Projektim ujësjellës kanalizime urbane – rurale.	Bazuar në detyrën e projektimit, parashikohet realizimi i sistemit te furnizimit me uje te zonave urbane dhe rurale, si rrjedhojë gjykohet që kjo pikë është e nevojshme për realizimin me sukses të shërbimeve të kërkuara.
<b>8- c</b>	Sisteme GIS.	Sisteme GIS është e nevojshme pasi objekti i kontratës përfshin mbledhjen, integrimin, përpunimin dhe analizimin e të dhënave gjeohapësinore të nevojshme për modelimin e sistemit të menaxhimit të ujërave të shiut, identifikimin e zonave me risk përmytjeje, analizën e alternativave të zhvillimit dhe hartimin e produkteve kartografike që përbëjnë pjesë integrale të studimit të fizibilitetit.
<b>9 – e</b>	Studime e projekte hidrogjeologjike.	Bazuar në detyrën e projektimit, projektuesi duhet te beje studime hidrogjeologjike te zones se burimeve perpara fillimit te projektit te zbatimi, si rrjedhojë gjykohet që kjo pikë është e nevojshme për realizimin me sukses të shërbimeve të kërkuara.

**2.3.3 Operatori ekonomik, duhet të ketë Staf si më poshtë, vërtetuar me kontratë pune të vlefshme/ kontrate bashkepunimi, diplomë, CV, librezë pune dhe të listuar në listpagesat e Shoqërisë për te pakten muajin e fundit nga data e zhvillimit të procedurës:**

- 1 (nje) Inxhinier Hidroteknik ( Drejtues projekti me eksperience jo me pak se 15 vjet)
- 1 (nje) Inxhinier Ndërtimi (konstruktor) ( me eksperience jo me pak se 10 vjet)
- 1(nje) Inxhinier Gjeodet.
- 1 (nje) Inxhinier Gjeolog
- 1 (nje) Inxhinier Mjedisi
- 1 (nje) Arkitekt/Urbanist

**Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 10 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM – së Nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.**

**Argumentim:** : Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Njësia e prokurimit për vendosjen e stafit i është referuar Termave të përgjithshme të references për objektet pjesë e kësaj procedure, pjesë e secilave do të jenë të licensuar për shërbimet që priten të realizohen.

**1. Inxhinier Hidroteknik (Drejtues Projekti)**

Nevojitet për:

Analizën hidrologjike të reshjeve dhe prurjeve të ujërave të shiut. Modelimin hidraulik të rrjetit të drenazhimit dhe kanalizimeve. Përcaktimin e kapaciteteve të nevojshme të kolektorëve, kanaleve dhe veprave të mbrojtjes nga përmytjet. Vlerësimin e rrezikut nga përmytjet dhe identifikimin e masave më efikase për menaxhimin e ujërave të shiut.

Ky është specialisti kryesor i studimit.

## **Eksperiencë – minimumi 15 vjet**

Drejtuesi i projektit ka përgjegjësinë për:

- koordinimin e të gjitha disiplinave teknike të përfshira në studim;
- drejtimin e analizave hidrologjike dhe hidraulike që përbëjnë thelbin e studimit;
- vlerësimin e alternativave teknike dhe ekonomike;
- sigurimin e cilësisë dhe koherencës së rezultateve të studimit;
- përfaqësimin teknik përballë autoritetit kontraktor dhe institucioneve të tjera.

Menaxhimi i një studimi të integruar urban për ujërat e shiut kërkon njohuri të fituara përmes pjesëmarrjes në projekte të shumta të ngjashme, përfshirë modelime hidraulike, plane drenazhimi urban dhe studime fizibiliteti. Për këtë arsye, eksperiencia prej jo më pak se 15 vjetësh konsiderohet garanci për aftësinë profesionale dhe menaxheriale të drejtuesit të projektit.

*Kërkesa për eksperiencë jo më pak se 15 vjet për Inxhinierin Hidroteknik në rolin e Drejtuesit të Projektit lidhet me kompleksitetin multidisiplinar të studimit, nevojën për koordinim të ekipeve të specializuara dhe përgjegjësinë për hartimin e zgjidhjeve teknike të qëndrueshme për menaxhimin e ujërave të shiut në një mjedis urban kompleks.*

## **2. Inxhinier Ndërtimi (Konstruktor)**

Nevojitet për:

Vlerësimin e zgjidhjeve strukturore të objekteve që mund të propozojë studimi, si rezervuarë, basene retencioni, mure mbajtëse, kanale të hapura, kolektorë dhe vepra të tjera drenazhimi. Analizën e qëndrueshmërisë dhe sigurisë së strukturave ekzistuese që ndikohen nga rrjedhjet e ujërave të shiut. Hartimin e alternativave teknike dhe vlerësimin paraprak të kostove të ndërtimit.

## **Eksperiencë – minimumi 10 vjet**

Kjo kërkesë mund të argumentohet sepse:

- studimi mund të propozojë vepra inxhinierike si kolektorë, rezervuarë retencioni, stacione pompimi, kanale dhe struktura mbështetëse;
- nevojiten vlerësime paraprake të realizueshmërisë strukturore dhe kostove të investimit;
- duhen analizuar kushtet e ndërtimit në mjedis urban ekzistues dhe ndërveprimi me infrastrukturën e tjera.

### 3. Inxhinier Gjeodet

Nevojitet për: Kryerjen e rievimeve topografike të zonës së studimit. Përcaktimin e kuotave, pjerrësive dhe konfiguracionit të terrenit. Hartimin e planeve topografike dhe modeleve dixhitale të terrenit. Sigurimin e bazës gjeohapësinore mbi të cilën realizohen analizat hidrologjike dhe hidraulike.

Pa të dhënat topografike të sakta nuk mund të përcaktohen drejtimet e rrjedhjes së ujit.

### 4. Inxhinier Gjeolog

Nevojitet për: Studimin e përbërjes së tokës dhe formacioneve gjeologjike. Vlerësimin e aftësisë infiltruese të terrenit dhe sjelljes së ujërave nëntokësore. Identifikimin e zonave me rrezik rrëshqitjesh, erozioni ose paqëndrueshmërie. Dhënien e rekomandimeve për vendosjen e veprave të drenazhimit dhe përzgjedhjen e zgjidhjeve të përshtatshme teknike.

### 5. Inxhinier Mjedisore:

Vlerëson ndikimet mjedisore të alternativave të propozuara. Analizon efektet mbi ujërat sipërfaqësore, ujërat nëntokësore, biodiversitetin dhe zonat e mbrojtura. Propozon masa për minimizimin e ndikimeve negative dhe rritjen e qëndrueshmërisë mjedisore.

### 6. Arkitekt / Urbanist

Analizon integrimin e zgjidhjeve në strukturën urbane ekzistuese dhe të planifikuara. Vlerëson përputhshmërinë me planet vendore dhe strategjitë e zhvillimit urban. Propozon zgjidhje që harmonizojnë infrastrukturën e drenazhimit me hapësirat publike dhe zhvillimin.

#### 2.3.4 Operatori duhet të ketë në pronësi ose me qera pajisjet e mëposhtme:

- Pajisje Total station cope 1 në pronësi ose me qera
- Pajisje GPS cope 1 në pronësi ose me qera

*Në lidhje sa më sipër operatori ekonomik duhet të paraqesë: Faturë shitblerje ose kontratë qeraje të noterizuar (shoqëruar me dokumentat e pranisë së qiradhënësit origjinal ose fotokopje e noterizuar) si dhe skedën teknike.*

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Për të përmbushur me sukses kontratën dhe realizimin e projektit në kohe, duhen pajisjet topografike për matje në terren për përcaktimin e kuotave dhe akseve të gjurmës së ujesjllës.

## Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

**2.3.5** Operatori ekonomik ofertues në përlogaritjen e ofertës duhet ti referohet njoftimit të bërë me Nr. 5585 Prot. datë 25.07.2017 të Agjensisë së Prokurimit Publik "Rekomandim mbi mënyrën e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.354 datë 11.05.2016 "Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim". Mospërgatitja e ofertës sipas bazës ligjore të sipërpërmendur përbën shkak për skualifikim pasi ajo duhet të jete brenda kufijve të vleres minimale dhe maksimale të lejuar në kuptim të nenit 7/1 të VKM nr 354, datë 11.05.2016 "Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikimin të territorit, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim.

**Argumentimi:** Është vendosur kjo kërkesë bazuar në njoftimin me Nr. 5585 Prot. datë 25.07.2017 të Agjensisë së Prokurimit Publik "Rekomandim mbi mënyrën e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.354 datë 11.05.2016 "Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim".

## II. Argumentimi i specifikimeve teknike

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët "ose ekuivalenti i tij/saj".***